



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 27.04.2018

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“LINJË TRANSMETIMI E ENERJISË ELEKTRIKE 110 KV SKURRAJ – LAC 1,
BASHKIA KURBIN”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “OST” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Linjë transmetimi e energjisë elektrike 110 Kv Skurraj – Laç 1, Bashkia Kurbin”, me subjekt zhvillues shoqërinë “OST” sh.a, miratuar me Vendimin Nr.1, datë 23.11.2016, të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Vendimin Nr. 1, datë 23.11.2016, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

